



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 19 maj 2014
Nr.ref.:RK625/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI230/13

Parashtrues

Tefik Ibrahimimi

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 7.5 të Ligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-072

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Tefik Ibrahimimi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Gjilan.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston nenin 7.5 të Ligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-072.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të shqyrtojë nëse neni 7.5 i Ligjit për zgjedhjet lokale, nr. 03/L-072, është në pajtim me nenin 45.1 të Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes].
4. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata që të *“bje posht ky nen dhe unë me vota të fituara më së shumti në subjektin tim politik AKR të zgjidhem këshilltar komunal në KK të Gjilanit”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 24 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 15 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI230/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI230/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
8. Më 28 janar 2014, parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 25 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi, si anëtar i partisë politike AKR (Aleanca Kosova e Re), ishte kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Gjilanit, në zgjedhjet lokale të mbajtura më 3 nëntor 2013.
11. Më 2 dhjetor 2013, Komisioni Qendror Zgjedhor (në tekstin e mëtejme: KQZ) i shpalli rezultatet e zgjedhjeve lokale. Sipas këtyre rezultateve, parashtruesi i kishte fituar 302 vota.

12. Pavarësisht kësaj, parashtruesi nuk u bë anëtar i Kuvendit Komunal të Gjilanit, sepse ulësja në Kuvendin Komunal ishte paraparë për kandidaten femër të partisë së njëjtë politike, e cila ishte e dyta në listë dhe e cila fitoi 69 vota, sipas dispozitave të Ligjit për zgjedhjet lokale, Nr. 03/L-072, për vendosjen e kuotës gjinore.
13. Më 3 dhjetor 2013, parashtruesi ushtroi ankesë në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (në tekstin e mëtejshëm: KZAP).
14. Më 6 dhjetor 2013, KZAP-i mori Vendimin A. nr. 1120/2013, duke e refuzuar ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e KZAP-it, thuhej *inter alia* se, “PZAP konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme, ngase shpërndarjen e ulëseve në kuvende komunale e bën KQZ-ja, në bazë të nenit 8 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale. Nga kjo nënkuptohet se është në kompetencë të KQZ-së, të bëjë shpërndarjen e ulëseve në kuvende komunale, për secilin kandidat për anëtarë të kuvendeve komunale duke respektuar kuotën gjinore, siç kërkohet sipas dispozitës së lartcekur”.
15. Parashtruesi paraqiti ankesë administrative në Gjykatën Supreme, brenda afatit të paraparë me ligj.
16. Më 12 dhjetor 2013, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin AA-Uzh. Nr. 8936/2013, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.
17. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme theksoi se “Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme konstatoi se PZAP ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt ligjin kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Tefik Ibrahimit, kandidat i Aleancës Kosova e Re (AKR), për asamblëist të KK të Gjilanit, sepse ai me asnjë provë nuk i ka argumentuar pretendimet e veta ankimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës, vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm, kurse arsyetimi i tij përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, e cila konstatoi se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt. Nisur nga kjo gjendje e mësipërme e çështjes, kjo Gjykatë konstatoi se gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të kërkesës, prandaj pretendimet e tij ankimore nuk u pranuan, sepse nuk kanë ndikuar në vërtetimin e një gjendjeje tjetër faktike nga ajo që ka vërtetuar PZAP”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi pretendon se “Në bazë të rezultateve finale të KQZ-ës dhe QNR-ës, në regjistrin e kandidatëve për këshillëtarë të Kuvendit Komunal të Gjilanit nga AKR-Aleanca Kosova e Re kam dal më i votuari me gjithsejtë 302 vota, ndërsa subjekti politik përmes të cilit kam qenë i kandiduar ka fituar dy mandate në Kuvendin Komunal të Gjilanit. Nga kjo, njëri mandat i është ndarë bartësit të listës dhe tjetri mandat kandidates së gjinisë femërore e cila ka marrë vetëm 69 vota”.
19. Parashtruesi më tej pretendon se “KQZ-ja ka ndar dy mandate subjektit në fjalë, duke përcaktuar se njëri mandat i takon bartësit të listës dhe tjetri mandat kandidates femër e cila ka 69 vota, ndarjen e tillë e bënë duke u

mbështetur në kuotën e 30%-it, çka konsiderojë se është e padrejtë dhe trajtim i pa barabartë dhe diskriminues”.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës, duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
21. Nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës përcaktojnë kornizën e përgjithshme ligjore për pranueshmërinë e kërkesave individuale. Ato përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
22. Gjykata vëren se parashtruesi nuk e konteston kushtetutshmërinë e Vendimit të KZAP-it, A. nr. 1120/2013 dhe të Aktgjykimit AA. Uzh. nr. 893/2013, të Gjykatës Supreme.
23. Në rastin konkret, parashtruesi kërkon *“të vlersojë kushtetutshmërinë e nenit 7, paragrafi 5 të ligjit nr. 03/L-072 Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës”*, duke parashtruar se *“Gjykata Kushtetuese duhet të konstatojë se a është në harmoni ky nen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 45, paragrafi 1”*.
24. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, si bazë juridike për ta dorëzuar kërkesën e tij.
25. Gjykata rikujton se vetëm autoritetet që janë të numëruara në mënyrë eksplicite në nenet 113.2 deri 113.6 të Kushtetutës janë palë të autorizuar për të ngritur në Gjykatë çështjet e vlerësimit abstrakt të kushtetutshmërisë dhe të kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së legjislacionit.
26. Duke pasur parasysh dispozitat e cituara të Kushtetutës, Gjykata vjen në përfundim se parashtruesi nuk është palë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë.
27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e ligjit në abstrakt, dhe, prandaj, kërkesa e tij duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (3) c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese




Prof. dr. Enver Hasani